



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 27 maj 2020, në mbledhjen e dytë (2) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom dhe z. Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së; z. Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Zaim Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhë në mbledhjen e dytë të KKS-së në vitin 2020. Fillimisht dua të ju përshëndes të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë kësaj periudhe të pandemisë. Jemi prej komunave të para në Kosovë që zyrtarisht jemi shpallë si komunë free dhe kjo vërtetë na bën të kënaqur të gjithëve.

Materialet konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 14 shkurt 2020

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, në fund të faqes 5 të procesverbalit është lëshuar një gabim, te emëri i Komandantit të Stacionit të Policisë, në vend të z. Bekim Bislimi, të përmirësohet me z. Bekim Zogiani.

Procesverballi u miratua njëzëri, me vërejtjen e paraqitur nga Nënkyetari i Komunës.

2.Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, gjatë periudhës së pandemisë sektorë të ndryshëm kanë pasur ndikime dhe detyra të ndryshme dhe një prej tyre që ndoshta pas sektorit të shëndetësisë ka qenë më i ngarkuari me punë dhe që ende vazhdon të mbetet është Policia e Kosovës. Para se t'ia kalojë fjalën komandantit të Policisë dua që publikisht atë dhe tërë stafin e tij ta falënderoj për një bashkëpunim të jashtëzakonshëm që kemi pasë në këto rrethana, ka qenë sfiduese edhe për Policinë por edhe për ne sigurisht, por besoj që bashkëpunimi i mirë që kemi pas ne si institucione por edhe i qytetarëve me Policinë e Kosovës në masë të madhe ka ndikuar që sot të kemi një situatë të qetë por edhe të menagjueshme. Fjalën e ka Komandanti i Stacionit Policor z. Bekim Zogiani.

z. Bekim Zogiani, theksoi, jemi duke kaluar me sfidën, me pandeminë Covid 19 që ka kapluar Kosovën si dhe gjithë botën, ku edhe komuna jonë ka qenë e prekur nga kjo. Sa i përket situatës së sigurisë, në përgjithësi e kemi të qetë, mirëpo ka qenë e ngarkuar me raste sidomos prej fillimit të pandemisë. Aktivitetet dhe angazhimet policore nuk kanë munguar. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi 313 raste të evidentuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku kanë qenë 268. Raste të vjedhjeve të rënda kanë qenë 69, numër i njëjtë sikurse në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Më shqetësuese kanë qenë rastet e dhunës në familje, nga 7 raste në vitin e kaluar ka ngritje në 18 raste në këtë periudhë raportuese. Numri i personave të arrestuar ka shkuar në 150 ndërsa në vitin e kaluar në këtë periudhë ishte 28.

Komandanti foli edhe për situatën e përfshirjes në karantinë të fshtreve, pas paraqitjes së rastit të parë. Nënvizoi, në respektimin e rregullave të parapara gjatë karantinës kanë qenë të angazhuar gjithsejtë 468 zyrtarë policorë. Karantina ka qenë e siguruar prej tri njësi policore. Nga data 12.04.2020- 02.05.2020 kanë qenë të angazhuara edhe tri njësi me gjithsejtë 294 zyrtarë policor nga Stacioni Policorë-Podujevë në sigurimin e karantinës të qytetit të Prishtinës, në kufirin administrativ në mes Komunës së Podujevës dhe Prishtinës.

Sa për njoftim nga data 09 mars kur ka filluar vetizolimi i personave në komunën tonë, kanë qenë të evidentuar gjithsejtë 212 persona në vetizolim, prej tyre 180 e kanë përfunduar vetizolimën dhe aktualisht i kemi 32 persona, bëhet fjalë për kohën e fundit për personat që kanë ardhur nga jashtë, të cilët janë kontrolluar nëpër pikat hyrëse por që nuk kanë shenja të prekjes dhe janë rekomanduar në vetizolim. Personat ende në vetizolim kontrollohen sa i përket rrespektimit të masave. Gjatë kësaj periudhe për mos respektim të vendimeve lidhur me pandeminë janë iniciuar gjithsejtë 56 raste sipas Kodit Penal të Kosovës. Ndaj pronarëve të lokaleve afariste të cilët nuk i kanë respektuar këto masa, në veçanti gastronomia janë iniciuar procedurat për 25 raste, ndërsa ndaj personave të cilët nuk e kanë respektuar kufizimin e lëvizjes janë iniciuar procedura për 31 raste me 84 persona. Gjatë kësaj periudhe kallëzime penale janë proceduar ndaj 111 personave në bazë të nenit 250 të KPK. Me ndryshimin e fazave të lëvizjes nga data 14-21 maj 2020 në Drejtorinë e Inspeksionit janë dorëzuar listat me 300 persona dhe 5 lokaleve afariste të cilët nuk kanë respektuar kohën e lëvizjes, gjegjësisht kufizimeve, për të aplikuar ndëshimet me gjoba. Mirëpo edhe përkundër shumë kërkesave të qytetarëve

për lëvizje Shtabi Emergjent dhe Policia ka qenë shumë aktiv. Policia ka pranuar shumë kërkesa dhe i ka kthyer përgjigje në mënyrën më të mirë të mundshme, bashkërisht me Drejtorinë e inspeksionit, ku kemi pasur një kontakt të vazhdueshëm dhe me të gjithë anëtarët e Shtabit Emergjent përmes rrjetit të viberit. Në përgjithësi e vlerësojmë një situatë që është menaxhuar mirë edhe nga ana e policisë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, sa i përket situatës së sigurisë e vlerësojmë të qetë dhe stabile. Gjendja me pandeminë është menaxhuar mirë, kjo kohë ka qenë mjaft sfiduese si për Policinë, qytetarët, institucionet tjera relevante, ashtu edhe për KFOR-in.

Pandemia me Covid 19 në masë ka ndikuar edhe në punën dhe aktivitetet e KFOR-it, pasi që kemi pasur kufizime të lëvizjes dhe të ushtrimit të aktiviteteve. Edhe pse nuk jemi dukur aq në këtë periudhë dymujore puna jonë ka shkuar në koordinim institucionet vendore të shëndetit publik. Edhe pse puna jonë është vështirësuar gjatë kohës së pandemisë, ne i kemi pasur kapacitetet operative. Dua të i falënderojë të gjitha institucionet komunale për bashkëpunimin që kemi pasur. Shpresojmë që kjo kohë e pandemisë të kryhet sa më shpejtë dhe të kthehemi në normalitet.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht dua të ju njoftojë se në mungesë të z. Besfort Kruma, në takimin e sotëm për zëvendësim ka ardhur z. Nexhip Jaha, i urojmë mirëseardhje dhe ia kalojmë fjalën.

z. Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së, fillimisht dua të ju përgëzoj për punën shtesë që keni bërë gjatë kësaj periudhe të pandemisë, si Komunë, Policinë, Drejtorinë e Arsimit, Shëndetësinë dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontribut. Sa i përket çështjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, FSK nuk ka pas ndonjë aktivitet të veçantë, mirëpo ka qenë e angazhuar me disa njësi në këtë periudhë kohore. Me krijimin e Qendrës së Situatave pran MPB-së, FSK ka qenë pjesë e asaj Qendre, po ashtu ka themeluar Shtabin Emergjent dhe nga kjo Qendër e Situatave FSK ka pritur kërkesa, sikurse ka qenë furnizimi i të gjitha pikave kufitare me kontejnerë në shërbim të personelit mjekësor, i cili ka pas për detyrë kontrollin e tërë atyre që hyjnë në territorin e Kosovës. Si detyrë primare gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë transporti i gjithë udhëtarëve qoftë nga Aeroporti, qoftë nga pikat tjera të hyrjes. Kjo punë është zhvilluar nga tri njësi (e logjistikës, transportit dhe Policia e forcës) që kanë qenë të angazhuara nga kjo Qendër e Situatave. Kjo ishte detyra kryesore e FSK-së në këtë situatë dhe jemi të gatshëm të shërbejmë çdo herë që paraqitet nevoja.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Nëse nuk keni diçka, unë do theksoja se gjatë kohës së pandemisë në disa portale ka qarkulluar se xhandarmëria serbe është futur në territorin e Kosovës, në pjesën e fshatit Dumnicë dhe do të doja të dija edhe pse nuk e kemi përfaqësuesin e Policisë kufitare këtu, nga përfaqësuesit e KFOR-it a ka ndonjë informatë lidhur me këtë, sa është e vërtetë dhe çfarë masash janë ndërmarrë lidhur me këtë veprim po që se është i vërtetë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, për çështjen e shtruar nga Nënkyetari i Komunës momentalisht nuk kemi ndonjë informacion nga ana e KFOR-it.

z. Bekim Zogiani, theksoi, për atë që theksoi Nënkyetari, informacion zyrtar nuk kemi, jemi informuar vetëm përmes mediave, por para se të dal ai informacion në media, personalisht vet jam angazhuar po atë ditë, kam dalë në terren, por nuk kam hasur. Nëse ka ndodhur diku tjetër, nuk kemi informacion zyrtar.

3. Informatë rreth gjendjes emergjente të krijuar nga Pandemia - Covid 19 në Komunën e Podujevës

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, para se të ia kaloj fjalën Drejtorit të DSHMS z. Zaim Thaçit, shkurtimisht desha të ju informoj rreth kësaj pike. Me lajmërimin e rastit të parë me covid 19 që ishte më 13 mars 2020, të njëjtën ditë kam themeluar Shtabin e Emergjencës dhe kemi mbajtur mbledhjen e parë në mbrëmje. Ende pa pasur ndonjë rast në Komunën e Podujevës ne kemi filluar me planifikimin se si do t'i përgjigjemi kësaj pandemie në rast se do të përhapet edhe pse kemi qenë të sigurt se do të përhapet edhe në Komunën e Podujevës. Fatkeqësisht më 15 mars veç e kemi pasur rastin e parë me covid 19, pastaj fshatrat; Dumnice e poshtme dhe e Epërme dhe Llaushë janë futur në karantinë dhe kjo ka qenë sfida jonë e parë për ne si Shtab, QKMF-në dhe në veçanti për Policinë e Kosovës. Pastaj kanë qenë rastet tjera po nga e njëjta familje, 18 mars, rasti i dytë i konfirmuar dhe fatkeqësisht diku më 20 mars veç e kemi pas humbjen e parë të jetës nga kjo familje. Pra rasti i parë i vdekjes nga covid 19 ka ndodhë pikërisht në territorin e Komunës së Podujevës dhe i shpreh ngushëllime familjes edhe njëherë për këtë humbje dhe kjo ka bërë që të mobilizohemi në një shkallë shumë më të lartë dhe bashkërisht me institucionet relevante të ndërmarrim masa të vazhdueshme e që më vonë janë dëshmuar se kanë qenë masa adekuate, që kanë ndikuar drejtë menaxhimit të pandemisë. Më 25 shkurt 2020 ne kemi themeluar pikën e kontrollit mjekësor në pikën kufitare në Merdarë dhe ajo pikë është mbajtur edhe pse është jashtë kompetencës komunale, menaxhohet ekskluzivisht nga stafi mjekësor i QKMF-së në Podujevë. Deri më tani rreth 8000 udhëtarë që kanë hyrë në Kosovë përmes kësaj pike që krahasuar me pikat kufitare tjera është numër dukshëm më i madh, janë kontrolluar në mënyrë rutinore nga stafi, dmth është një punë kolosale në aspektin shëndetësor në këtë fushë. Pastaj kemi pas edhe dy raste tjera, një në fshatin Bradash dhe një e kthyer nga Italia, por që pas trajtimit në klinikën infektive janë shëruar plotësisht. Në statistika nëse e shihni e vëreni se në hartën e pandemisë në Komunën e Podujevës figurojnë se janë 11 raste me covid 19, ju siguroj se nuk janë 11 raste por 9 raste, sepse dy raste si duket nga ngutia janë diagnostifikuar gabimisht, ata persona dy herë i kanë përsëritur analizat dhe kanë rezultuar negativ, mirëpo statistikën kanë mbetur ato të vjetrat. Prej tyre 8 raste janë të shëruar plotësisht, ndërsa fatkeqësisht 1 prej tyre ka ndërruar jetë. E gjithë puna që ka bërë Shtabi Emergjent ka qenë bashkëpunimi dhe koordinimi në vazhdimësi me institucionet e ndryshme relevante, konformë situatës. Ju jeni në dijeni se Komuna ka ndarë edhe buxhet shtesë për tu dal në ndihmë qytetarëve. Fillimisht unë si ushtrues detyre i kryetarit kam ndarë një shumë prej 10,000 €, pastaj duke parë se kjo gjendje pandemike do të zgjatë dhe përmes Kuvendit i kemi ndarë 125,000 €, të cilat i kemi dedikuar si ndihmë qytetarëve në nevojë. Nga këto mjete janë siguruar 2280 pako ushqimore dhe higjienike të cilat i kemi ndarë në për të gjitha fshatrat dhe në territorin e qytetit, por po ashtu dua të falënderoj edhe donatorët me të cilët kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe ata kanë ofruar pako ushqimore dhe higjienike herë pas herë, të cilat i kemi shpërndarë nga organizata Kryqi i Kuq por edhe nga zyrtarët komunal dhe me ndihmën e vullnetarëve. Ka qenë një periudhë sfiduese që për herë të parë ne si institucione ballafaqohemi në një situatë të përmasave të tilla dhe vërtetë ka qenë një testim që unë besoj edhe qytetarët e vlerësojnë se e kemi kryer me sukses dhe është vënë një themel i përgjigjes adekuate në rast se kemi situata të tilla apo të emergjencave të ndryshme. Motoja e të gjithë ne në shtab në atë periudhë ka qenë që mos të lejojmë të shkaktohet panikë, sepse kemi vlerësuar se paniku është armiku më i madh në këso situata. Mund të them se nga 20 prilli në territorin e Komunës nuk kemi pas asnjë rast të konfirmuar me covid 19 dhe kjo vërtetë na bën të lumtur por edhe të besojmë që punët që i kemi kryer kanë ndikuar. Nuk ka qenë e lehtë për t'i mbajtur fshatrat në karantinë, kemi qenë pothuajse të parët në Kosovë që kemi vendosë qytetarë dhe fshatra në karantinë. Më

vonë kur filluan edhe pjesët tjera të vihen në karantinë qytetarët e kuptuan që është e domosdoshme. Si rezultat i kësaj ka pas presion të madh qoftë në administratën komunale, qoftë në Policinë, sektorin e shëndetësisë, pse vetëm këto katër fshatra në Kosovë, pse vetëm ne. Këto masa vërtetë nuk kanë qenë të lehta për qytetarët pos as për ne, por kanë qenë të domosdoshme dhe janë treguar të suksesshme sepse kanë penguar përhapjen e covid 19 dhe kjo na ka ndihmuar që ta kemi situatën nën kontroll. Për detaje shëndetësore dhe të tjera fjalën e ka z. Zaim Thaçi.

z. Zaim Thaçi, ashtu sikurse e përshkruajti Nënkryetari, në muajin shkurt 2020 kemi alarmin nga IKSHP për Kosovën për situatën e pandemisë nga covid19. Ne me shumë seriozitet si Drejtori e Shëndetësisë dhe Komunë e kemi vëzhguar situatën dhe kemi qenë në bashkëpunim të vazhduar që nga fillimi i muajit shkurt për situatën epidemiologjike në vendin tonë dhe me datën 13 mars kemi takimin e parë që llogaritet takim i parë për një emergjencë të shëndetit publik në Komunën tonë. Takimi është bërë në kërkesë të Nënkryetarit të Komunës i cili llogaritet si bartësi kryesor në formimin e Shtabit të Emergjencës. Shtabi i Emergjencës i paraprinë organizimit të të gjitha strukturave shëndetësore dhe ato të sigurisë si dhe të gjitha institucionet relevante që dhanë kontribut për menaxhimin e situatës së krijuar nga epidemia covid 19. Ne kryesisht u përqendruam në fazën e parë të organizimit, morën rekomandimet nga IKSHP dhe OBSH dhe filluam mobilizimin e punëtorëve shëndetësor dhe të tjerë të organeve të sigurisë në kuptimin e organizimit dhe dhënies së kontributit secili në fushën përkatëse. Çështje tjetër në takimet e shpeshta të Shtabit ishte bartja e rekomandimeve të IKSHP, zbatimi i masave dhe furnizimi me pajisje parandaluese mbrojtëse të cilat veç janë të njohura dhe janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë dhe organizimi i shërbimeve të reja në kuadër të QKMF-së, siç është pika e kontrollit shëndetësor në vendkalimin kufitar në Merdar, shërbimi i triazhimit, shërbime këto të organizuara me profesionistë shëndetësorë, për periudhë kohore 24/7. Çështje tjetër e cila i ka paraprirë kësaj ka qenë organizimi dhe kontraktimi i kompanisë e cila ka bërë dezinfektimin e hapësirave publike, ambientet e banimit privat të familjeve apo pjesëtarët e tyre të cilët kanë të konfirmuar me covid 19 dhe hapësirave shëndetësore dhe të tjera për të cilat kemi menduar se janë të frekuentueshme. Sikurse e elaboroi Nënkryetari, fillimisht ndau një shumë prej 10,000 € dhe pastaj edhe Kuvendi një shumë prej 125,000 €, shumë e cila është paraparë të shpërdahet përmes pakove ushqimore dhe higjienike. Deri më tani janë shpërndarë 2280 pako familjeve në nevojë. Vlen të përmendet se që nga data 20 prill nuk kemi asnjë pacient të konfirmuar pozitiv me covid 19. Testet dhe raportet i kemi çdo ditë nga IKSHP të cilat na japin të dhënat për gjendjen e pacientëve të cilët janë të ftuar për covid 19 por të gjithë po rezultojnë negativ dhe është një fat i mirë dhe ndjenjë e mirë edhe për institucionet dhe qytetarët të cilët kontribuan që të kemi një situatë epidemiologjike nën kontroll. Përfundimisht mund të thuhet se ndoshta barrën kryesore e patëm të gjitha institucionet nën menaxhimin e Nënkryetarit të Komunës të cilët dhanë kontributin e tyre së bashku me qytetarët. Nëse dikush ka diçka që i intereson, jam i hapur për pyetjet e juaja.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, gjithashtu dua të ju informoj se gatë kësaj periudhe kemi themeluar edhe Qendrën Operative Lokale e cila fillimisht ka punuar 24 orë, pastaj me qetësimin e situatës ka vazhduar punën në dy ndërrime dhe ende funksion. Përmes mediave është bërë publike edhe numri i qasjes. Qytetarët kanë bërë kërkesa por edhe pyetje, kryesisht ju kanë referuar lejeve për qarkullim. Ky shërbim e ka kryer një punë të mirë. Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur një shërbim pak më të veçantë, një grup i psikologëve me të cilët kemi dakorduar që ata të bëjnë një shërbim psiko-social për të gjithë qytetarët në nevojë dhe realisht ka pas thirrje të shumta prej

qytetarëve(69 persona) të cilët kanë kërkyar seriozisht ndihmë psiko-sociale prej psikologëve. Kanë qenë të vendosur në objektin e Komunës dhe seancat janë zhvilluar on-line. Ata kanë kryer një punë të mirë përveç largimit të stresit, depresionit, panikës por edhe të problemeve të ndryshme familjare, shpëtimit të martesave përmes këshillimeve. Drejtori e përmendi dezinfektimin, vetëm desha të theksoj se në çfarë përmase është bërë, sepse me dezinfektim jemi duke vazhduar, janë dezinfektuar me dhjetra herë hapësirat publike në qytet, hapësirat e shtëpive, pronave dhe oborreve të familjeve që kanë rezultuar pozitiv me covid 19, hapësirat e institucioneve qoftë komunale qoftë shëndetësore, Stacioni i Policisë etj. dhe vërtetë kjo ka qenë një ndërmarrje e madhe e masave, ngase kemi vlerësuar se dezinfektimi i vazhdueshëm i vendeve që kanë qenë të frekuentuara, në veçanti QKMF-së, emergjencës, QMF-ve, i dhomës së Triazhimit, që kanë pas kontakte të vazhdueshme me qytetarë të dyshuar me covid 19 ka dhënë rezultatet e veta. Po ashtu i kemi kushtuar rëndësi dezinfektimit të lagjeve të caktuara, duke ditur gjendjen sociale të lagjeve të komunitetit rom dhe ashkali në qytet disa herë i kemi dezinfektuar ato lagje dhe në masën më të madhe nga ata banorë ka qenë e mirëpritur edhe pse ndonjëherë ka pas kundërshtime se nuk ka nevojë të dezinfektohet shpesh, ndoshta sepse mund të mendojnë se mund të jetë i dëmshëm, por duhet ta kuptojnë se nuk shkakton kurrfarë dëmi, përkundrazi. Të gjitha këto janë bërë në mënyrë që ta mbajmë në kontroll, të pengojmë zgjerimin, ta luftojmë në burim covid 19. Në mënyrë telegrafike këto kanë qenë aktivitetet që i kemi ndërmarrë si Shtab dhe Komunë, përndryshe kemi mbajtur mbledhje të rregullta sa herë që kemi pas nevojë, dhe gjithë situatën e kemi pasur nën kontroll, gjë që tregon edhe rezultati, sepse në një territor kaq të madh siç është komuna e Podujevës e cila është më e madhja me territor në nivel vendi, pothuajse me 100,000 banorë, prej komunave të para të prekura me covid 19 ta kemi një gjendje të tillë, vërtetë është për të na bërë krenarë ne dhe qytetarët e Komunës së Podujevës. Shpresoj që mos të kemi më këso raste. Kemi bërë një përvojë dhe në rast se kemi ndonjë emergjencë të çfarëdo lloji, do të dimë të jemi më mirë të organizuar dhe si t'i përgjigjemi çdo sfide.

Kam një informatë zyrtare, përfaqësuesit e OSBE-së që vazhdimisht monitorojnë dhe marrin pjesë në takime të KKS-së, më kanë informuar se edhe përkundër kërkesës që kanë bërë në selinë e tyre qendrore në Vjenë, për të lejuar për të marrë pjesë në këtë takim dhe të tjera, është vendim i selisë qendrore që stafi i OSBE-së, të mos merr pjesë në asnjë lloj tubimi dhe jo vetëm në Kosovë deri sa të kalojë pandemia. Nëse nuk ka dikush tjer diçka rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

4. Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve dhe djegieve të pyjeve (koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent)

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, para se t'ia kaloj fjalën Drejtorit të DBPZHR, desha të theksoj se në këtë periudhë kohore kemi pas dhe ballafaquar me shumë zjarre dhe po thuajse na është bërë si dukuri të shfaqen në çdo stinë të pranverës, qoftë të paqëllimshme, qoftë edhe të qëllimshme. Kjo vërtetë është një barrë për institucionet por edhe dëm ekonomik dhe ambiental. Fatmirësisht me gjithë përpjekjet e shtuara të zjarrfikësve, rojeve të pyllit, policisë dhe të qytetarëve kemi arrit që brenda pak kohe të vëmë nën kontroll këto zjarre, por dëmet janë të mëdha. Fjalën e ka Drejtori z. Vezir Januzi.

z. Vezir Januzi, theksoi, si pasojë e kushteve atmosferike, thatësisë, temperaturave të larta, e në disa raste edhe erërat e forta që kanë mbretëruar gjatë datës 19.02.2020-19.04.2020 janë shfaqur zjarre në 44 raste, kryesisht me intenzitet të ulët dhe të mesëm. Në shfaqjen e tyre konsiderojmë se shkaktar kryesor është faktori njeri. Qytetarët duke pastruar livadhet e tyre, mandej shëtitjet e tyre gjatë periudhës së pandemisë. Për rastet e zjarreve janë informuar organet e rendit dhe besoj që veç kanë filluar hetimet për këto raste. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtorinë e Inspeksionit, Policinë por edhe me qytetarë jemi munduar që zjarret të mos marrin përmasa dhe që të mos kemi ndonjë rast që të përfshijë edhe shtëpitë e qytetarëve dhe raste të tjera në persona. etj. Kemi një sipërfaqe bukur të madhe të përfshirë nga zjarreth dhe dëmet janë të konsiderueshme. Komisionet janë në terren për të bërë vlerimin e dëmeve. Në këtë kohë duhet të përgatitemi sepse tani në fund të muajit qershor dhe fillim të korrikut fillojnë korje – shirjet dhe së bashku me institucionet tjera koordinuese si DSHPMSH, Drejtorinë e Inspeksionit, Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, do të përgatiten plane dhe do të kontaktojmë edhe qytetarët dhe organizatat tjera për përgatitjen e një plani menaxhues lidhur me parandalimin e këtyre zjarreve që mund të na paraqiten kryesisht gatë korje shirjeve. Me një koordinim të mirë të të gjitha institucioneve besoj se do të ia dalim gjatë sezonit të verës. Është bërë praktikë që APK për çdo vit në muajin qershor angazhojnë një numër të madh të punëtorëve sezonal, por është mirë që edhe Komuna e Podujevës të shikojë mundësitë që të angazhojmë një numër të zjarrfikësve gjatë kësaj sezone. Në kuadër të mundësive do të ishte kërkesë që edhe rojet e pyjeve të jenë të pajisura me pajisje përkatëse që të intervenojnë dhe të pengojnë përhapjen e zjarrit deri sa të arrijnë zjarrfikësit. Shqetësim tjetër për Drejtorinë e Bujqësisë është në vijën kufitare që e kemi nga fshati Metergoc deri në Leposaviq ku rojet e pyjeve përgjegjëse kanë pranuar informata të cilat i kanë dërguar te ne, të ilustruara edhe me fotografi ku dëshmohet se në këtë rajon ka kalime ilegale të kufirit me ç'rast në brendi të territorit tonë futet masë drunore e cila më vonë vihet në qarkullim. Prandaj kërkojmë nga organet e rendit që të veprojnë që të ndalohet kjo dukuri. Kjo masë drunore e marrë në mënyrë ilegale po paraqet problem me rastin e kryerjes së shërbimeve në pyjet private nga se po bëhet përzierja e masës drunore gjatë qarkullimit dhe kontrollave që kryhen nga ne dhe nga policia. Në këtë takim do të ishte mirë që dikush nga policia kufitare të ishte prezent në këtë takim, pasi që janë më kompetent. Në bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha instucionet relevante shpresojmë të eliminojmë këtë dukuri negative.

z. Faik Muçiqi, Shërbimi i Zjarrfikësve gjatë kësaj periudhe deri më 25 maj ka bërë 258 intervenime dhe duhet falënderuar që posaqërisht gjatë kohës së pandemisë kanë shkuar edhe në vendet të cilat kanë qenë në karantinë, dmth, angazhimi i tyre është vlerësuar në nivelin e lartë. Struktura e zjarreve është; 20 raste djegie të objekteve ndërtimore shtëpi banime dhe objekte tjera ndihmëse, dmth., 132 raste tjera janë djegie të pyjeve, pishave etj. 7 raste djegie të fushave dhe kullosave. Në strukturë ende dominojnë djegia e pyjeve fushave dhe kullosave. Në 36 raste të tjera është intervenuar në aksidente të komunikacionit, raste tjera të ndryshme etj.

Sipërfaqe të përafërta sipas vlerësimit të dëmtuar nga diegiet janë 343 ha në pyje, ndërsa në fusha janë afër 102 ha. Shqetësim i përhershëm mbeten akterët e këtyre zjarreve. Nga asnjë zjarr deri më tani është konstatuar se shkaktar është temperatura e lartë, do të thotë faktori njeri ka qenë shkaktari kryesor. Shërbimi i Zjarrfikësve është i pajisur me mekanizëm të mjaftuar, modern dhe të ri, servisimet janë bërë me rregull, me pajisjet tjera ndihmëse furnizohet çdo vit, por vlen të theksohet se intervenimet në pyje janë mjaft specifike dhe kërkohen mjete specifike dhe më shumë personel, sepse në intervenime nuk

mund të hyhet me mekanizëm të rëndë, cistena etj. këtë vit krahas numrit të punëtorëve(18) kemi angazhuar edhe dy punëtor me kontratë mbi vepër dhe nga data 2 qershori planifikojmë të marrim edhe 2 punëtorë tjerë dhe shpresojmë që edhe APK të angazhojë punëtorë shtesë gjatë sezonit sikurse vitet e kaluara dhe nuk e di pse gjatë kësaj periudhe nuk kanë angazhuar kur kishte kërkesa jashtëzakonisht të mëdha në kohë pandemie dhe kur u përballëm me zjarre, pra ky agjencion ka pasur mundësi të angazhojë punëtorë shtesë. Mendoj se në takimet tjera do të kemi raporte qoftë nga Policia qoftë tjera se këta dëmtues megjithatë duhet të ndalen dhe penalizohen sepse nëse janë të qëllimshme atëherë nëse me vite të tëra nëse nuk kemi të dënuar, këto do të na persëriten.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj teme, e përmbysim dhe kalojmë në pikën e radhës.

5. Të ndryshme

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, a ka dikush diçka në pikën të ndryshme , nëse jo atëherë unë po mundohen të rikapituloj çka biseduam deri më tani, jo për ti përsëritur ato që u diskutuan. Sikurse jeni në dijeni nga data 1 qershor kalojmë në fazën e tretë të sjelljes si institucionale ashtu edhe individuale ndaj pandemisë dhe prej kësaj date do të ketë lehtësime shtesë, madje lehtësime shtesë janë paralajmëruar edhe prej ditës së nesërme, por zyrtarisht në fazën e tretë hyjmë me një qershor, datë nga e cila do të ketë aktivitet të shtuar ekonomik, dhe sipas disa informacioneve mund të pritët që disa shkolla të rihapen, ndoshta për maturantët dhe semimaturantët, pastaj në shkolla sigurisht se do të organizohet edhe testi i maturës dhe testi i arritshmërisë dhe këto do të jenë sfida për të gjithë ne, rreth organizimit, zbatimit të masave dezinfektimit etj.

Pastaj edhe xhamitë do të jenë në dispozicion të xhematit që të kryejnë ritet fetare. Edhe nga këshillimi i Bashkësisë Islame ka kërkesë që të bëhet dezinfektimi i hapësirave të xhamive, pra duke përfshirë dezinfektimin e shkollave qerdheve dhe xhamive do të jetë sfiduese për Komunën, nuk jemi në dijeni se MASHT-i a ka dhënë ndonjë sinjal se është e gatshme të merret me dezinfektimin e objekteve shkollore. Komuna e kryen në vazhdimësi dezinfektimin por nuk ka buxhet për t'i dezinfektuar objektet shkollore çdo ditë pas përfundimit të orarit të mësimi, sepse vetëm në institucionet arsimore në Komunë janë mbi 72,000 m², kështu që ndoshta Drejtori i DKA-së do të duhej të pyet në MASHT. Vetëm desha të ju tregoj se sa serioze është nëse hapen shkollat. Edhe pse xhamitë nuk janë institucione në kuadër të administratës komunale, do të shohim mundësitë, sepse tani jemi në fund të shpenzimit të kontratës dhe kontrata e re nuk është lidhur ende për shkak të afateve ligjore. Në rast se hapen shkollat atëherë kostoja për komunë është e pa përballueshme.

Gjatë këtij takimi nuk patëm fare kohë të ndalemi në çështjen shumë të rëndësishme, nuk folëm fare për pandeminë ekonomike, një numër i madh i qytetarëve kanë mbetur pa punë, bizneset nuk kanë mundur të zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe ne si komunë jemi shumë të brengosur, por në radhë të parë do të duhej brengosur Qeveria, se si do të mund të ndihmonte bizneset, në mënyrë që kاتا të fillojnë me ushtrimin e veprimtarive për rimëkëmbjen e tyre sepse e dimë se problemi ekonomik do të jetë problem i madh këtë vit edhe për shkak të zvogëlimit të të hyrave vetanake, po flas për Komunën tonë edhe pse kjo gjendje është në të gjitha komunat, sepse ata nuk kanë ushtruar veprimtaritë e tyre. Sigurisht jeni në dijeni se në fillim të pandemisë covid 19 kemi marr vendim me të cilin bizneset i kemi liruar nga taksa komunale, po ashtu i kemi liruar edhe nga taksa e pagesës së qirasë ato biznese që shfrytëzojnë hapësira dhe objektet komunale, pra do të kemi një hyrje të të ardhurave shumë më të vogël por edhe kërkesa të shtuara nga personat, familjarët për asistencë sociale. Në fakt ne do ta kalojmë pandeminë, por për një kohë të

gjatë do të ballafaqohemi me pasoja nga kjo pandemi dhe një prej tyre është mundësia që shumë bashkatdhetarë që kryesisht vinë duke filluar nga muaji korrik deri në shtator e që remitencat e tyre janë një mbështetje e madhe për familjet e tyre por edhe ekonominë lokale dhe atë në nivel vendi, do të jenë pasoja që nuk do të kalohen lehtë. Por shëndeti është në radhë të parë, ta kalojmë këtë sfidë, e pastaj për të tjerat do të shohim si do të organizohemi në përballimin e tyre. Unë shfrytëzoj rastin që të gjithë juve të ju falënderoj dhe të ju uroj shëndet juve dhe familjeve të juaja në këtë periudhë të rëndë shëndetësore që kemi kaluar dhe po kalojmë, me shpresë që në takimin e radhës do të kemi krejt diçka tjetër dhe të bisedojmë për çështje jo shëndetësore.

Nënkryetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut

Mbledhja përfundoi në orën 11.15

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/03-0022408/20
Podujevë, 27 maj 2020**

**Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari**